



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 8 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144 dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2014, miratoi:

### **VENDIM**

### **PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM**

#### **Neni 1**

z. Agron Hyseni, për shkak të emërimit, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në Komisionin vlerësues për dhënie e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, zëvendësohet me këshilltarin e Kuvendit nga radhët e LDK – së, përkatësisht me

z. Afrim Shabani

#### **Neni 2**

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënie e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, nr. 01-006-23423 të datës 13 mars 2014.

#### **Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë, përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-006-45861**  
**Podujevë,**  
**27 maj 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehmet Gashi**

